




Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Udhëzues për pajisje me Vërtetim tatimor për Persona Fizik



Përmbajtja

Lista e figurave	1
1.Hyrje.....	2
2. Regjistrimi i llogarisë për <i>Vërtetim tatimor</i>	3
3. Kyçja	4
4.Shkarkimi i <i>Vërtetimit tatimor</i>	6
5.Kërkimi i <i>Vërtetimit tatimor</i>	8
6. Rigjenerimi i fjalëkalimit.....	9

Lista e figurave

Figura 1: <i>Ballina e aplikacioni për lëshimin Vërtetim Tatimor</i>	2
Figura 2: <i>Faqja për regjistrim të shfrytëzuesit për hapje të llogarisë</i>	3
Figura 3: <i>Shfaqja e mesazhit konfirmues pas regjistrimit të shfrytëzuesit</i>	3
Figura 4: <i>Konfirmimi me email pas regjistrimit</i>	4
Figura 5: <i>Kyçja</i>	4
Figura 6: <i>Ballina pas kyçjes</i>	5
Figura 7: <i>Faqja për shkarkimin e vërtetimit tatimor</i>	6
Figura 8: <i>Vërtetimi tatimor</i>	7
Figura 9: <i>Faqja për kërkim të vërtetimit tatimor</i>	8
Figura 10: <i>Nr. serik i vërtetimit tatimor</i>	9
Figura 11: <i>Faqja për rigjenerim të fjalëkalimit</i>	9

1.Hyrje

Ky udhëzues shërben për të gjithë Personat fizik, të cilëve ju nevojitet dokumenti i vërtetimit tatimor për nevoja të ndryshme, si: aplikim për vizë, lirim nga shtetësia, fitim i shtetësisë, vazhdim i lejes së qëndrimit në Kosovë, pushim i lehonisë, etj.

Për të shkarkuar vërtetimin tatimor, shfrytëzuesi i qaset linkut <http://evertetimi.atk-ks.org/> në uebfaqen e ATK-së www.atk-ks.org, me ç'rast shfaqet faqja si në figurën vijuese:





Figura 1: Ballina e aplikacioni për lëshimin Vërtetim Tatimor

Fillimisht shfrytëzuesi duhet të ketë llogari të hapur, në mënyrë që të kyçet dhe të ketë mundësi që t'a shkarkojë vërtetimin tatimor. Nëse ka llogari tatimore atëherë klikon në butonin *Kyçu*, në faqen si në fig. 1, përndryshe ai/ajo duhet të klikojë në butonin *Regjistrohu* në të njëjtën figurë.

2. Regjistrimi i llogarisë për Vërtetim tatimor


Pasi të klikohet në butonin *Regjistrohu* nga fig.1, shfaqet faqja si në fig. 2:



The screenshot shows a web page for VAT verification registration. At the top left is the logo of the Tax Administration of Kosovo. To its right, the text reads: "Administrata Tatimore e Kosovës", "Poreska Administracija Kosova", and "Tax Administration of Kosovo". In the top right corner, there are two buttons: "Regjistrohu" and "Kycu". Below the logo, there are links for "Ballina" and "Kërko Vërtetimin", and language options "ALB | ENG | SRB". The main heading is "Regjistrimi i llogarisë për Vërtetimi Tatimor". Below this, there are five input fields: "Numri Personal", "Emri dhe mbiemri", "Telefoni", "Email", and "Konfirmo Email". A yellow warning box contains the text: "Duke klikuar mbi 'Regjistrohu' më poshtë, ju jeni duke rënë dakord me **Kushtet e Kontratës**". At the bottom center is a "Regjistrohu" button.

Figura 2: Faqja për regjistrim të shfrytëzuesit për hapje të llogarisë

Pas plotësimit të të gjitha fushave, leximit të kushteve të kontratës dhe klikimit në butonin *Regjistrohu* në faqen si në fig 2 shfaqet mesazhi konfirmues "Regjistrimi përfundoj me sukses, konfirmimin do ta merrni me email".



The screenshot shows a confirmation message page. At the top left is the logo of the Tax Administration of Kosovo. To its right, the text reads: "Administrata Tatimore e Kosovës", "Poreska Administracija Kosova", and "Tax Administration of Kosovo". In the top right corner, there are two buttons: "Regjistrohu" and "Kycu". Below the logo, there are links for "Ballina" and "Kërko Vërtetimin", and language options "ALB | ENG | SRB". The main heading is "Mesazh konfirmues". Below this, the text reads: "Regjistrimi përfundoj me sukses, konfirmimin do ta merrni me email." At the bottom left, there is a small copyright notice: "© 2013 - Administrata Tatimore të Kosovës".

Figura 3: Shfaqja e mesazhit konfirmues pas regjistrimit të shfrytëzuesit

Emri i shfrytëzuesit dhe fjalëkalimi dërgohet në emailin e shfrytëzuesit, të cilin ai/ajo e ka shkruar në fushën *Email*, në fig 2.





Figura 4: Konfirmimi me email pas regjistrimit


3. Kyçja


Pasi të klikohet në butonin *Kyçu* nga fig.1, shfaqet faqja si në fig. 5. Shkruhet shfrytëzuesi (numri personal) dhe fjalëkalimi i cili është dërguar në emailin konfirmues dhe pas klikimit në butonin *Kyçu*, shfrytëzuesi kyçet në aplikacion me ç'rast ai/ajo mund të bëjë kërkesën për vërtetim tatimor apo të shkarkojë vërtetimin tatimor.



The screenshot shows the login page of the tax administration system. At the top left, there is the logo of the Tax Administration of Kosovo and the text 'Administrata Tatimore e Kosovës', 'Poreska Administracija Kosova', and 'Tax Administration of Kosovo'. Below this, there are links for 'Ballina' and 'Kërko Vërtetimin'. At the top right, there are buttons for 'Regjistrohu' and 'Kyçu'. In the center, there is a form titled 'Kyçja' with two input fields: 'Shfrytëzuesi' and 'Fjalëkalimi (Rigjenero)'. Below the input fields is a 'Kyçu' button. At the bottom right, there are language options: 'ALB | ENG | SRB'.

Figura 5: Kyçja



 Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Çkyqju
1000000000, Personi X
personi@domain.com

Ballina | Shkarko Vërtetimin | Kërko Vërtetimin | Profili Juaj

ALB | ENG | SRB

Mirë se vini në shërbimin tonë online për Vërtetimin Tatimor

Administrata Tatimore e Kosovës, të gjithë Personave Fizik ju ofron mundësinë e paisjes me vërtetim tatimor në mënyrë elektronike. Shkarkimi i vërtetimit tatimor bëhet online, i cili nga ju do të shfrytëzohet , për:

- Aplikim për vizë
- Lirim nga shtetësia
- Fitim i shtetësisë
- Vazhdim i lejes së qëndrimit në Kosovë
- Pushim të lehonisë
- Tjera (shkruani arsyen për të cilën nevojitet vërtetimi i kërkuar)

Për mënyrën e përdorimit të këtij ueb aplikacioni, ju lutem referojuni udhëzimit për paisje me vërtetim tatimor ([shkarko udhëzimin](#))


Vërtetimi Tatimor do të lëshohet varësisht nga gjendja e juaj në ATK dhe atë, me njërin nga arsyet:

- **Personi është i regjistruar në ATK dhe nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore**
- **Personi është i regjistruar në ATK dhe ka borxhe tatimore apo obligime tjera tatimore të pa shlyera**
(Nëse ju keni dëshmi mbi pagesën e borxheve apo konsideroni se gjendja e juaj nuk është në rregull, atëherë vizitoheni Zyren Regjionale të cilës i përkthni. Aty do t'ju mundësohet pajisja me vërtetim tatimor me gjendjen reale)
- **ATK nuk ka shënime për personin**
(Nëse ju jeni të punësuar, por nuk keni shënime në sistemin e ATK-së, atëherë vizitoheni Zyren Regjionale të cilës i përkthni. Aty do t'ju mundësohet pajisja me vërtetim tatimor me gjendjen reale)

Figura 6: Ballina pas kyçjes

4.Shkarkimi i Vërtetimit tatimor

Në faqen në figurën 6 klikohet në *Shkarko Vërtetimin* dhe shfaqet faja për plotësimin e fushave të nevojshme për shkarkim.



The screenshot shows a web interface for tax verification. At the top left is the logo of the Tax Administration of Kosovo. To its right, the text reads: "Administrata Tatimore e Kosovës", "Poreska Administracija Kosova", and "Tax Administration of Kosovo". On the top right, there is a "Çkyq" button and user information: "1000000000, Personi X" and "personi@domain.com". Below this, there are navigation links: "Ballina", "Shkarko Vërtetimin", "Kërko Vërtetimin", and "Profili Juaj". On the far right, there are language options: "ALB | ENG | SRB". The main heading is "Shkarkimi i Vërtetimi Tatimor". Below this, there are several input fields: "Emri dhe mbiemri" with the value "Personi X", "Numri Personal" with the value "1000000000", "Komuna" with the value "PRISHTINË", and "Arsyeja e lëshimit" with a dropdown arrow. Below these fields is a large empty text area. At the bottom center, there is a "Gjenero Vërtetimin" button.

Figura 7: Faqja për shkarkimin e vërtetimit tatimor

Përveq fushave *Emri i personit*, *Numri personal* dhe *Komuna* të cilat shfaqen automatikisht, fushat *Adresa*, *Arsyeja e lëshimit* dhe fusha për arsye tjera të lëshimit nëse ka, duhet të plotësohen nga shfrytëzuesi. Klikohet në butonin *Gjenero Vërtetimin* me ç'rast shkarkohet *Vërtetimi tatimor* i cili duket si në fig.8.

	Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria - Vlada - Government Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo	
VËRTETIM TATIMOR TAX VERIFICATION PORESKA POTVRDA		
Administrata Tatimore e Kosovës verifikon se personi i identifikuar më poshtë: Tax Administration of Kosovo certifies that the person identified below: Poreska Administracija Kosovo overava da dolje identifikaciono lice:		 1000000050
Emri i personit: Name of Person: Ime lice:	Personi X	
Numri Identifikues Personal: Personal Identification Number: Identifikacioni Lični Broj:	1000000000	
Numri Fiskal: Fiscal Number: Fiskalni Broj:	600000000	
Komuna: Municipality: Opština:	Prishtinë	
Data: Date: Datum:	23.05.2013	
Arsyeja e lëshimit: Reasoning: Razlog izdavanja:	Aplikim për vizë	
ka këtë gjendje tatimore në ATK: has the following tax position with the TAK: ima sledeću poresko stanje u PAK:		
Personi është i regjistruar në ATK dhe nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore This person is registered with TAK and has no current outstanding tax debts or other obligations Lice je registrovana u PAK i nema aktuelne neisplaćene poreske dugove ili drugih poreskih obaveza		
ATK vërteton se informatat e dhëna janë të sakta dhe të plota me datën e këtij vërtetimi tatimor, mirëpo, ky vërtetim nuk përjashton obligimet tatimore që mund të lindin në të ardhmen.		
ATK certifies that this information is correct and complete as of the date of this verification, but this verification does not exclude future tax obligations.		
PAK overava da su date informacije tačne i potpune sa datumom ove potvrde, ali ova potvrda ne isključuje poreska obaveza koja mogu nastati u budućnosti.		
Vërtetimi vlen 6 muaj nga data e lëshimit The verification is valid for 6 months from the day it is issued Potvrda vazi 6 meseci od dana kada je izdata		
Verifikimin e këtij vërtetimi tatimor, mund ta bëni në linkun - Verification of this tax verification, you can do on the link - Verifikaciju ove poreske potvrde, možete uveravati i linku: eVertetimi.atk-ks.org/TaxVer/ReadTaxVer		
Nr. Formës VT - 2; Korrigjuar më 30.04.2013		

Figura 8: Vërtetimi tatimor

5.Kërkimi i Vërtetimit tatimor

Për të kërkuar vërtetimin tatimor të shkarkuar paraprakisht në faqen si në fig.6, klikohet në *Kërko vërtetimin* dhe shfaqet faqja për kërkim si në fig.9.




Figura 9: Faqja për kërkim të vërtetimit tatimor

Në fushën *Numri Serik* shkruhet numri serik i vërtetimit tatimor të shkarkuar (shih fig. 10), në rastin tonë *1000000028* dhe pas klikimit në butonin *Kërko*, shfaqen të dhënat e tjera për vërtetimin përkatës nëpër fushat *Numri Personal*, *Emri i Personit*, *Komuna*, *Arsyeja e lëshimit*, *Gjendja tatimore* dhe *Vlefshmëria*.




Figura 10: Nr. serik i vërtëtimt tatimor

6. Rigjenerimi i fjalëkalimit

Për rigjenerim të fjalëkalimit, në faqen si në fig.5, pas klikimit në linkun *Rigjenero*, shfaqet faqja si në vijim:

Figura 11: Faqja për rigjenerim të fjalëkalimit

Pas plotësimit të fushave *Numri Personal*, *Email* dhe *Konfirmo Email* dhe klikimit të butonit *Rigjenero*, kredencialet e shfrytëzuesit përkatës dërgohen në email.